

***KODI ETIK
DHE
KOMPLIANCA***

**TË PUNOSH ME MEGAPHARM DO TË THOTË QË NE DUHET TË
VEPROJMË GJITHMONË ME INTEGRITET PËR T'U SIGURUAR QË
KEMI BESIMIN E KLIENTËVE, KOLEGËVE DHE PARTNERËVE
TANË TË BIZNESIT.**

**“BESIMI QËNDRON NË THEMEL TË ÇDO GJËJE
QË BËJMË.”**

Ne presim që ju:

- *të silleni në mënyrë etike, të jeni krenarë për veprimet dhe vendimet tuaja*
- *të pajtoheni me parimet dhe rregullat e “kudit tonë të sjelljes” dhe të përmbushni detyrimet ligjore dhe rregullatore*

Nëse jeni menaxher, ju keni një rol të rëndësishëm për të siguruar që “kodi i sjelljes” të kuptohet dhe zbatohet nga ekipi juaj. Në veçanti, ne presim që ju:

- *të jeni një rol model për “të vepruar si duhet”*
- *të siguroni që pjesëtarët e ekipit tuaj ta njohin dhe kuptojnë kudin tonë*
- *të mbani përgjegjës anëtarët e ekipit tuaj që të zbatojnë kudin tonë.*

Parimet tona të biznesit | sjellja Individuale

Ne veprojmë me ndershmëri, integritet dhe drejtësi në punën tonë, si në marrëdhëniet e brendshme, ashtu edhe në ato të jashtme. Ne nuk tolerojmë asnjë formë rryshfeti, përfshi ofertat e parregullta të pagesave ose dhuratat për ose nga punonjësit. Ne shmangim të gjitha kontratat që mund të çojnë, ose sugjerojnë një konflikt të interesit ndërmjet aktiviteteve personale dhe ato të biznesit. Ne as nuk japim dhe as nuk marrim mikpritje ose dhurata që mund të duket se mbartin një detyrim. Ne zhvillojmë marrëdhënie përfituese të përbashkëta dhe përpiqemi ta promovojmë zbatimin e parimeve tona të biznesit me partnerët tanë të biznesit .

***“MEGAPHARM KA ZERO TOLERANCË NDAJ RYSHFETIT:
ASNJË PUNONJËS I MEGAPHARM NUK DUHET TË JAPË OSE
MARRË RYSHFET NË ASNJË LLOJ FORME.
RYSHFETI ËSHTË, JO VETËM I PALIGJSHËM, POR EDHE JOETIK.”***

KONFLIKTET E INTERESIT

Nëse e gjeni veten në një situatë ku interesat tuaja personale dhe ato të biznesit mund të bien ndesh, ju duhet të deklaroni këto konflikte të mundshme, të merrni aprovimin për to .Çdo konflikt interesi duhet të shmanget/eliminohet. Për t'ju ndihmuar të vendosni nëse po përballeni me ndonjë konflikt të mundshëm interesi, imagjinoni sikur veprimet tuaja po ua shpjegoni shokëve, kolegut a koleges ose medias dhe pyesni veten nëse do të ndiheshit mirë apo jo. Menaxheri juaj do të mund t'ju ndihmojë për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë konflikt.

Këtu janë disa shembuj të konflikteve të interesit :

- çdo aktivitet jashtë biznesit që ndikon në uljen e aftësisë tuaj për t'i kushtuar kohën dhe vëmendjen e duhur përgjegjësive tuaja brenda Megapharm
- rekrutimi i një individi për shkak të lidhjeve të tij të rëndësishme politike të cilat supozohet se do të gjenerojnë përfitime për Megapharm
- një interes personal ndaj një klienti ose konkurrenti i cili ndikon vendimet tuaja në punë
- përdorimi i burimeve të Megapharm për aktivitete politike.

DHURATAT DHE MIKPRITJA

Ne e mbështesim dhënien dhe marrjen e arsyeshme dhe proporcionale të mikpritjes në kuadër të marrëdhënieve normale të biznesit. Megjithatë, ne ndalojmë dhënien ose marrjen e dhuratave dhe mikpritjes nëse janë të tepërta apo jo të arsyeshme. Ne duhet të sigurohemi që të mos influencohemi kurrë, ose të mos kërkojmë të influencohemi me anë të dhuratave ose mikpritjes. Për shembull, ne nuk japim ose marrim dhurata ose mikpritje gjatë një procesi tenderimi ose gjatë negociatave për një kontratë të re.

MBROJTJA E INFORMACIONIT:

Të gjitha dokumentat, prezantimet dhe emaillet janë informacione thelbësore biznesi të cilat duhet të mbrohen. Informacione që qarkullohen brenda kompanisë vetëm sipas nevojës për informim ose, për palët e treta, në bazë të një marrëveshjeje për mospërhapje informacionesh. Cënimi i sigurisë do të çonte në dëmtim të reputacionit dhe dëm të konsiderueshëm financiar. Shembujt përfshijnë: të dhënat e klientëve dhe ato personale, marrëveshjet tregtare dhe informacioni për produktet.

SHËNDETI DHE SIGURIA

Ne presim që të gjithë në Megapharm të sillen në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme gjatë gjithë kohës. Ne do të ndërhyjmë shpejt nëse ndodh të kompromentohet shëndeti ose siguria. Vetëm nëpërmjet përgjegjësisë kolektive ne mund të sigurojmë se produktet dhe shërbimet tona janë të sigurta për t'u përdorur nga klientët tanë.

- Zbatoni “Rregullat absolute” për t'u kujdesur për veten dhe sigurinë e të tjerëve*
- Ndërhyni shpejt nëse shikoni që dikush po sillet në mënyrë të pasigurt*
- Raportoni incidentet, rreziqet e mundshme dhe incidentet potenciale, me qëllim që të ndihmojmë në nxjerrjen e mësimëve dhe në parandalim*
- Merrni parasysh se si vendimet dhe veprimet tuaja do të ndikojnë shëndetin dhe sigurinë si dhe të tjerët*
- Vlerësoni dhe njihni performancën e mirë të sigurisë.*



Building a Healthy Future Together